



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Kosova Cumhuriyeti



REPUBLIKA E KOSOVES + REPUBLICA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Drejtoria e Financave, e Ekonomise dhe e Zhvillimit
Direktorijat za Financije, Ekonomiju i Razvoj
Menaxh. Ekonomik e Kalkulina Muduriqju

104/02 Nr. 117 Dt. 09.06.2023



Kuvendi Komunal Prizren
Skupstina Opština Prizren
Prizren Belediyesi

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026

Qershor 2023



Republika e Kosovës
 Republika Kosova
 Republic of Kosova



Kuvendi Komunal Prizren
 Skupstina Opstina Prizren
 Municipal Assembly Prizren

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE **2024 - 2026**

Korniza afatmesme buxhetore komunale e Prizrenit, është pjesë përbërëse e Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) të Kosovës, është e përpiluar në përputhje me procedurat buxhetore 2024-2026, të dhëna nga MFPT (Ministria e Financave Punës dhe Transfereve) përmes Qarkores buxhetore 2024/01 për Komunat si dhe financimi nga grandet ndërqeveritare dhe kufijtë fillestar të buxhetit komunal për vitin 2024 dhe parashikimet për 2025-2026. Ky dokument i ka kushtuar rendesite të veqante alokimit të buxhetit nga aspekti i barazise gjinore. Korniza afatmesme buxhetore (KAB) komunale paraqet një mjet të procesit për zhvillimin e buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme tri vjeçare. Me Kornizën Afatmesme Buxhetore – Komunale, do të paraqesim shpjegimet e politikave dhe prioritetëve duke u bazuar në komponente barazise gjinore duke marrë për bazë nevojat e grave dhe burave gjatë planifikimit nga aspektet e punesimit, përfituesve të bursave , participimin në vendimarrje në projekte të ndryshme, kultura, subvencionet, pjesëmarrje në degjime publike etj. të tanishme dhe afatmesme të Komunës së Prizrenit, si dhe projeksionet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbush dhe përkrah projektet me prioritet, duke promovuar rritjen e mireqenies sociale dhe familjare me fokus të veqante në grupet në nevojë dhe barazine gjinore që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2024– 2026 gjithnjë duke u bazuar në :

- Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal
- Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit
- Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe
- Ligjin për Kufijtë Administrativ Komunal

I. Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore, KAB, që po prezantohet është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike duke marrë për bazë nevojat grave dhe burimeve dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshëm për arritjen objektivat prioritare, të identifikuara në dokumentet strategjike të komunës, përmes integritit sa më të mirë në procesin buxhetor.

Kuadri Ligjor: Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2023-2025 të lëshuara nga Ministria e Financave në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritar të zhvillimit dhe identifikimin e prioritetëve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2024-2026. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB Komunale dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:

